

SISTEMI ARSIMOR NË NORVEGJI

NGA FËMIJËRIA E HERSHME TEK TË RINJTË

Informacione për prindërit e kujdestarët e
porsa ardhur



PËRMBAJTJA

Edukimi dhe kujdesi në fëmijërinë e hershme (mosha 0–6) Në Norvegjisht: barnehage.....	3
Arsimimi fillor dhe i mesëm i ulët (moshat 6–16) në Norvegjisht: grunnskole.....	3
E drejta dhe detyrimi për të ndjekur shkollën fillore dhe të mesme të ulët	
Vlerësimet dhe notat.....	4
Programet para dhe pas shkollës (në Norvegjisht: SFO).....	4
Arsimimi i mesëm i lartë për të rinjtë (moshat 16–24) në Norvegjisht: videregående opplæring.	4
Aplikimi për shkollën e mesme të lartë	5
Programet për studime të përgjithshme (në Norvegjisht: studieforbredende utdanningsprogram)	5
Programet arsimore profesionale (në Norvegjisht: yrkesfaglige utdanningsprogram)	5
Të drejtat për të gjithë nxënësit	6
Trajnimi gjuhës së veçantë	6
Ndihma fillestare në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta	6
Arsimi special	6
Ambienti mësimor i sigurt dhe pozitiv.....	6
Bashkëpunimi midis shkollës dhe shtëpisë.....	7

KUJDESI DHE EDUKIMI I FËMIJËS NË FAZAT FILLESTARE (MOSHAT 0-6) NË NORVEGJISHT: BARNEHAGE

Shumica e fëmijëve në Norvegji ndjekin qendrat e kujdesit dhe të arsimit të fëmijëve, shpesh të quajtura kopshte fëmijësh, derisa të fillojnë shkollën në moshën kur ata mbushin 6 vjeç.

Në kopsht fëmijët kujdesen nga një personeli i kualifikuar që mundëson mësimin, lojën dhe aktivitete të ndryshme sociale dhe kulturore. Në kopsht fëmijët shpenzojnë kohë në të dyja: jashtë edhe brenda tij. Kopshti është i rëndësishëm për zhvillimin e gjuhës, zhvillimin social dhe fizik të fëmijëve.

Bashkëpunimi dhe dialogu midis prindërve apo kujdestarëve dhe kopshtit është thelbësor. Kopshti do të ketë nevojë për informacione rreth prejardhjes së fëmijës, si për shembull: gjuha amtare dhe gjuhët e tjera që flasin, interesat dhe vështirësitë e mundshme, për të plotësuar në mënyrë efektive nevojat e fëmijës. Kopshti do t'u japë gjithashtu informacion prindërve/kujdestarëve rreth veprimtarive të përditshme të zhvillimit të fëmijës.

Të gjithë fëmijët kanë të drejtën e një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm në kopsht. Kopshti nxit një komunitet gjithëpërfshirës dhe parandalon bullizmin dhe sjellje të tjera të dëmshme. Nëse fëmija i nënshtrohet bullizmit ose sjelljeve të tjera të dëmshme nga fëmijët e tjerë ose të rriturit, kopshti ka për detyrë të marrë masa në kundër përgjigje.

Fëmijët me nevoja të veçanta mund të kenë të drejtën për mbështetje dhe udhëheqje të veçantë arsimore. Kjo vlen edhe për fëmijët që nuk janë të regjistruar në kopsht. Ndihma e ofruar përshtatet me nevojat e fëmijës.

Kopshtet janë publike dhe private. Ju mund të kontaktoni komunën tuaj për informacion më të detajuar mbi të drejtat, aplikimin, pagesën si prind dhe mundësitë në komunitetin tuaj.

ARSIMI FILLOR DHE I MESËM I ULËT (MOSHAT 6-16 VJEÇ) NË NORVEGJISHT: GRUNNSKOLE

Fëmijët dhe të rinjtë e moshës 6-16 vjeç kanë të drejtë dhe detyrim për të ndjekur arsimin fillor dhe të mesëm të ulët. Bashkia ofron falas, arsimin fillor publik dhe të mesëm të ulët në dispozicion për të gjithë fëmijët. Shkollat private zakonisht kërkojnë një pagesë.

Fëmijët normalisht e fillojnë shkollën sapo mbushin 6 vjeç. Shkolla fillore zgjat për shtatë vjet nga klasa e parë deri në klasën e shtatë. Shkolla e mesme e ulët zgjat për tre vjet, nga klasa e 8-të deri në klasën e 10-të.

Viti shkollor zakonisht fillon në mes të Gushtit dhe përfundon në mes të Qershorit. Fëmijët dhe të rinjtë që mbërrin në Norvegji përgjatë vitit shkollor, do të regjistrohen në shkollë sa më shpejtë që të jetë e mundur.

E drejta dhe detyrimi për të bërë shkollën fillore dhe të mesme të ulët

Fëmijët dhe të rinjtë që mbërrin në Norvegji kanë të drejtë të ndjekin shkollën fillore dhe të mesme të ulët nëse mendojnë se ata do të qëndrojnë në këtë vend për më shumë se tre muaj.

Bashkia është e detyruar ta regjistrojë fëmijën në shkollë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se një muaj pas mbërritjes në këtë vend.

Ndërkohë që fëmijët dhe të rinjtë kanë jetuar në Norvegji për tre muaj, ata janë të detyruar që të ndjekin një shkollë fillore ose të mesme të ulët publike apo një institucion arsimor të përafërt.

Vlerësimet dhe notat

Në shkollën fillore, nxënësit i marrin vlerësimet po pa nota. Në shkollën e mesme të ulët, nxënësit marrin vlerësime me të dyja, me dhe pa nota.

Notat nga shkolla e mesme e ulët përdoren për nxënësit që aplikojnë për në shkollën e mesme të lartë. Shkalla e notës shkon nga 1 në 6, ku 6-ta që është nota më e lartë e mundshme.

Programet para dhe pas shkollës (shkurt në norvegjisht si SFO)

SFO u ofrohet si para ashtu edhe pas shkollës dhe mundëson lojëra e aktivitete kulturore dhe argëtuese nën mbikëqyrjen e një personeli të kualifikuar. SFO më shpesh ndodhin në mjediset e shkollës ose me mjediset e lidhura me shkollën.

Shumica e komunave ofrojnë SFO-s për të gjithë fëmijët e klasave 1-4 dhe për fëmijët me nevoja të veçanta në klasat 1-7.

Programet para dhe pas shkollës mundësojnë lojërat, mësimin dhe veprimtaritë e ndryshme sociale e kulturore sipas moshës së fëmijës dhe nivelit të zhvillimit. Programet nxisin përkatësinë dhe miqësinë, që janë të rëndësishme për zhvillimin shoqëror, kulturor e gjuhësor të fëmijëve.

Pjesëmarrja në programet para dhe pas-shkollë është vullnetare. Ju mund të kontaktoni komunën tuaj për informacion më të hollësishëm mbi pjesëmarrjen në SFO dhe pagesën si prind.

ARSIMI I MESËM I LARTË PËR TË RINJTË (MOSHAT 16-24) NË NORVEGJISHT: VIDEREGÅENDE OPPLÆRING

Të rinjtë që kanë përfunduar shkollën e mesme të ulët në Norvegji ose një arsim të përafërt në një tjetër vend, kanë të drejtën e arsimit të mesëm të lartë.

Kjo, gjithashtu vlen edhe për ata që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë në një vend tjetër që nuk u njihet për pranim të përgjithshëm në universitet dhe në kolegje apo si një kualifikim profesional në Norvegji.

Shumica e nxënësve regjistrohen në shkollën e mesme të lartë vitin që mbushin 16 vjeç. Aplikantët e rritur (25 vjeç e lart) mund të kenë të drejtë për një arsim të mesëm të lartë të organizuar veçanërisht për të rriturit.

E drejta për t'u futur në shkollën e mesme të lartë, kërkon banim ligjor në Norvegji. Të rinjtë që qëndrojnë në vend ndërsa aplikimi i lejes së qëndrimit të tyre është akoma duke u shqyrtuar, kanë të drejtën e arsimit të mesëm të lartë kur janë nën moshën 18 vjeç dhe ka të ngjarë që ata të qëndrojnë në vend për më shumë se tre muaj. Të rinjtë që qëndrojnë në vend ndërsa presin të marrin lejen e qëndrimit dhe që mbushin moshën 18 vjeç gjatë vitit, kanë të drejtë ta përfundojnë vitin shkollor akademik.

Aplikimi për shkollën e mesme të lartë

Arsimi i mesëm i lartë ndahet në programe për studime të përgjithshme dhe arsim profesional. Viti i parë është referuar si "vg1" dhe aplikuesi tregon tre preferencat e para të programeve të ndryshme dhe ka të drejtë të pranohet në një prej tyre. Nxënësi duhet të aplikojë për çdo vit (vg1, vg2 dhe vg3).

Si rregull, të rinjtë aplikojnë për shkollë të mesme të lartë në qarkun ku jetojnë.

Autoritetet e qarkut janë përgjegjëse për të ofruar falas arsim të mesëm të lartë publik. Ka edhe shkolla të pavarura/private që zakonisht kërkojnë një pagesë.

Afati i fundit i aplikimit për pranimin në shkollën e mesme të lartë është 1 Shkurti ose 1 Marsi i çdo viti. Afati përfundimtar i aplikimit të 1 Shkurtit zbatohet kryesisht për nxënësit që kanë arritur kohët e fundit në Norvegji, u mungojnë notat nga shkolla e mesme e ulët për shkak të trajnimit të veçantë të gjuhës ose kanë të drejtën për një vlerësim të veçantë në aplikimit e tyre.

Për më shumë informacion rreth arsimit të mesëm të lartë, procesit të aplikimit dhe të pranimit, ju lutemi kontaktoni autoritetet e qarkut tuaj ose shkoni në www.vilbli.no, i cili u jep informacione në gjuhë të ndryshme.

Programe për studime të përgjithshme (në Norvegjisht: studieforberedende utdanningsprogram)

Programet për studime të përgjithshme ofrojnë kualifikime të përgjithshme ose specifike për pranim në universitet dhe në kolegji. Notat nga shkolla e mesme e lartë përdoren kur nxënësit aplikojnë për arsim të lartë në kolegje dhe universitete.

Programet për studime të përgjithshme kanë një kohëzgjatje akademike prej tre vitësh.

Aplikantët mund të zgjedhin midis programeve të mëposhtme për studime të përgjithshme:

- Specializim për studime të përgjithshme
- Art, projektues (dezinjator) dhe arkitekturë
- Edukim fizik dhe sporte
- Muzikë, vallëzim dhe drama
- Komunikim dhe Media

Programet e arsimit profesional (në norvegjisht: yrkesfaglige utdanningsprogram)

Programet e arsimit profesional ofrojnë një kualifikim profesional, me ose pa certifikatë të profesionit ose certifikatë e marrë duke punuar e studiuar njëkohësisht. Një kualifikim profesional i jep individit kredencialet për të ushtruar një profesion.

Programet e arsimit profesional kanë një kohëzgjatje normale prej tre vjetësh marrje mësimesh në klasë ose dy vjet mësimesh në klasë dhe dy vjet praktikë në një kompani. Është gjithashtu e mundur të regjistrohen në një program shtesë për certifikim pranimi në universitete dhe kolegje.

Aplikantët mund të zgjedhin midis programeve të mëposhtme të arsimit profesional:

- Ndërtim dhe konstruksion
- Inxhinieri elektrike dhe teknologji kompjuterike

- Parukeri, projektues lulesh, projektues i ambienteve të brendshme e tregtare
- Shërbim shëndetësor, zhvillimi fëmijërisë dhe i rinisë
- Artizanat, projektimi dhe zhvillimi i produkteve
- Informacion i teknologjisë dhe prodhimi i mediave
- Bujqësia, peshkimi dhe pyllëzimi
- Restorantet dhe përpunimi i ushqimeve
- Shitjet, shërbimet dhe turizëmi
- Prodhimi teknologjik dhe industrial

TË DREJTAT PËR TË GJITHË NXËNËSIT

Këto të drejta u përkasin nxënësve të shkollave fillore, të mesme të ulët dhe të mesme të lartë.

Trajnim i veçantë i gjuhës

Nxënësit me një gjuhë tjetër amtare se Norvegjishtja apo Sami, që nuk flasin Norvegjisht ose kanë aftësi të dobëta në gjuhën Norvegjeze, kanë të drejtë për trajnim gjuhësor të veçantë. Kjo e drejtë do zbatohet derisa gjuha e tyre Norvegjeze të jetë mjaft e mirë për ata që të ndjekin dhe të përfitojnë nga arsimiti i rregullt.

Trajnimi i veçantë i gjuhës përbëhet nga mësimet shtesa në gjuhën Norvegjeze, dhe gjithashtu mund të përbëhet nga:

- Mësim në gjuhën amtare të nxënësit
- Arsimiti dygjuhësh – që kombinon mësimin në një ose më shumë lëndë në Norvegjisht dhe në një gjuhë tjetër që nxënësit e zotërojnë

Shkollës i kërkohet të vlerësojë aftësitë e nxënësit në Norvegjisht për të përcaktuar se çfarë lloj gjuhe e veçantë është e përshtatshme për nxënësin.

Mbështetja fillestare në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta

Fëmijët dhe të rinjtë që sapo kanë mbërritur në Norvegji, mund t'i marrin pjesë në të gjitha ose në disa grupe shkollore, klasa apo shkolla të veçanta për një periudhë deri në dy vjet. Qëllimi është të mësohet gjuha Norvegjeze shpejt, para se të hyjnë në shkollat ose klasat e rregullta.

Fëmija/i riu dhe prindërit apo kujdestari i tij ose i saj, duhet të jenë të mirë informuar në lidhje me përmbajtjen e programit fillestar, dhe miratimin për të hyrë në një program të tillë. Fëmija /i riu dhe prindërit ose kujdestari i tij/e saj, mund të zgjedhin në vend të këtij programi të hyjnë në shkollë ose klasat e rregullta.

Arsimi i veçantë

Nxënësit që nuk përfitojnë ose nuk mund të përfitojnë mjaftueshëm nga arsimiti i rregullt, mund të kenë të drejtën e arsimimit të veçantë. Edukimi i veçantë mund të thotë se nxënësi punon në objektivat e mësimin të përshtatur individualisht, që një mësues ose asistenti monitoron dhe ndihmon nxënësin në klasë ose që nxënësi të pajiset me aparate posaçërisht të përshtatura. Arsimiti i veçantë përshtatet me nevojat specifike të nxënësit.

Mjedis mësimi i sigurt dhe pozitiv

Të gjithë nxënësit kanë të drejtën për një mjedis të sigurt dhe pozitiv të të mësuarit që nxit

shëndetin e mirë, mirëqenien dhe shkollimin. Është përvoja e vetë nxënësit për mjedisin shkollor që ka rëndësi. Të gjithë nxënësit duhet të provojnë ndjenjën e përkatësisë. Është përgjegjësia e shkollës të parandalojë bullizmin dhe sjellje të tjera të dëmshme. Shkollës i kërkohet të mbikëqyrë situatën dhe të marrë masa në qoftë se një nxënës nuk ndjehet i sigurt apo mirëqenie në shkollë.

Bashkëpunimi midis shkollës dhe shtëpisë

Bashkëpunimi midis shkollës, nxënësit dhe prindërve ose kujdestarëve është i rëndësishëm. Kjo e ndihmon shkollën të mbështesë më mirë nxënësin dhe kontribuon në zhvillimin e mirë akademik dhe shoqëror.

Prindërit ose kujdestarët janë të detyruar të ndjekin zhvillimet e bisedimeve me shkollën dhe fëmijën si edhe mbledhjet me prindër për të gjithë prindërit e klasës ose grupit që fëmija i përket.

Prindërit ose kujdestarët janë gjithmonë të mirëpritur të kontaktojnë me shkollën për ndonjë pyetje apo shqetësim rreth edukimit dhe zhvillimit të fëmijës së tyre.

